

Shitja me pakicë

Tanimë me paga minimale

2

Iniciativa e kontestuar

Të ardhura minimale për të gjithë

3

Portret aktivistësh

Me artisten dhe aktivisten Liri Lushi

4

Nr. 6 | nëntor 2013 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Revidimi i tërësishëm i ligjit mbi shtetësinë

Për një politikë korrekte natyralizimi



Të eliminohet diskriminimi



Aksion sensibilizimi me parlamentarët



Të prekur edhe fëmijët



Të rinjtë kërkojnë trajtim të drejtë



Protesta e komisionit për migracion të sindikatave dhe FIMM-it

Ka kohë që vijon revidimi i tërësishëm i ligjit mbi shtetësinë. Këtë vit të dy këshillat federal janë këshilluar mbi projektligjin, së fundi këshilli federal i përfaqësuesve kantonal në sesionin vjeshtor. Deri tani sikur qeveria ashtu edhe parlamenti kanë humbur rastin të ndërrojnë mendje përkitazi me politikën e natyralizimit dhe integritimit. Në vijim një pasqyrë e shkurtë.

Migrantet e migrantët japin kontribut të rëndësishëm për shoqërinë tonë dhe për ekonominë. Politikanët zviceran duket se nuk duan të pranojnë e të njohin një fakt të tillë, apo në rastin më të mirë bëjnë vetëm premtime boshe. Në secilin rast kërkesa e kamotshme e Unia-s për ndryshim të kësaj politike mbetet larg realizimit, pasi në projekt propozimin aktual për revidimin e tërësishëm të ligjit mbi shtetësinë dominojnë përkeqësimet karshi lehtësimeve. Posaçërisht të prekur janë fëmijët dhe rinia.

Të diskriminohen të rinjtë?

Parlamenti i diskutoi propozimet e qeverisë federale, të cilat paraqisnin përkeqësime karshi rregullave të na-

nishme qysh në mars të këtij viti dhe i intensifikoi ato fuqishëm. Një përkeqësim parashihte, që vitet, të cilat i mbushin fëmijët dhe të rinjtë mes moshës 10 deri 20 vjeç përkitazi me llogaritjen e viteve të mos numërohen më dyfish. Edhe pse këta fëmijë janë socializuar në Zvicër, si duket nga politikanët edhe më tej perceptohen si të huaj.

Këshilli federal nuk pajtohet

Këshilli federal në sesionin e vjeshtës ka kthyer mbrapshtë disa nga vendimet shtrënguese të parlamentit: Llogaritja e dyfishite e viteve tek të rinjtë vlen edhe më tej, ndërsa afatet e vendbanimit duhet shkurtuar si dhe parakushtet e njohjes së gjuhës të mos

ngritën pa nevojë. Parlamenti donte që ata që duan të marrin shtetësinë të dëshmojnë njohuri «në të folur dhe të shkruar», çka paraqet diskriminim të qartë për migrantët e paarsimuar. Disa shtrëngime përkeqësimi këshilli federal megjithatë i aprovoi: Kështu marrja e shtetësisë për bashkëshortët të përkeqësohet më tej - duke kthyer «lehtësimin» e marrjes së shtetësisë për bashkëshortët në marrje normale shtetësie - ndërsa leja e përhershme e qëndrimit duhet të futet si kriter iu marrjes së shtetësisë.

Viza C si parakusht

Viza C në të ardhmen duhet të jetë parakusht për marrjen e shtetësisë. Kjo vlen qysh tani në shumë kantone, e sipas parlamentit duhet të vlejë në të gjitha kantonet. Një vështirësim tjetër paraqet koha e kaluar në Zvicër me lejen F, e cila tani e tutje nuk do të numërohet fare. Kështu këshilli federal diskriminon para së gjithash të pranuarit e përkohshëm, e posaçërisht fëmijët e tyre, të cilët kanë ikur nga

regjione lufte e krize dhe shpesh janë të socializuar këtu.

Jo diskriminimit

Kundër këtyre përkeqësimeve më 16 shtator protestuan para pallatit federal aktivistet/ët e komisionit për migracion të Unionit të Sindikatave Zvicerane, të FIMM-it, të SEV-migracionit si dhe të Unia-s, bashkë me një grup fëmijësh dhe të rinjsh. Ata kërkuan nga parlamentarët që të shfrytëzojnë revidimin e tërësishëm të ligjit mbi shtetësinë, për të rregulluar në mënyrë korrekte marrjen e pasaportës zvicerane.

Një politike korrekte e dhënies së shtetësisë do të arrihet kur politikanët të pranojnë, se participimi politik është një ndër parakushtet për tu integruar suksesshëm dhe për tu kuptuar si pjesë të shoqërisë zvicerane. Përmes politikës së pandërprerë diskriminuese përjashtohen posaçërisht njerëzit e rinj, të cilët praktikisht tërë jetën e tyre e kanë kaluar në Zvicër.

➔ Aurora García

Editorial



Për kushte korrekte pune në shitjen me pakicë

Pagat e ulëta dhe vende pune të pasigurta. Kjo formulë e shkurtë vlen për shumë vende punë në shitjen me pakicë. Punë me orë, punë me porosi dhe pasiguri, athua sa do të jetë paga në fund të muajit. Me këtë situatë konfrontohen përditë shumë shitëse e shitës. Ata fitojnë çerekun, bile edhe të kualifikuarit, profesionistët në shitoret e veshjeve apo të mbathurave, më mpak se 3690 franga. Dhe këtë edhe pa pagën e 13-të. Këtu ndihmon vetëm një gjë: Iniciativa e sindikatës Unia për pagën minimale. Në të ardhmen askush nuk duhet të fitojë më pak se 4000 franga. Për këtë ne duhet të luftojmë së bashku. Krahas pagave të ulëta edhe mungesa e respektit e punëdhënësve karshi personelit shitës paraqet problem. Gjithashtu edhe refuzimi i tregtarëve me pakicë që të negociojnë me sindikatat një Kontratë Kolektive të Punës. Një shembull jashtëzakonisht negativ paraqet supermarketi SPAR. Shitëset e kualifikuara aty nuk arrijnë të fitojnë më shumë se sa 3600 franga. Ndërsa në shitore ka mungesë personeli. Përderisa shefat e SPAR-it edhe përkundër bisedimeve nuk duan të ndryshojnë asgjë, të punësuarave në filiale të Dättwil-it u humbi durimi dhe bënë grevë. Greva më e gjatë në shitje me pakicë përfundojë pa zgjidhje. Spar-i i pushoi nga puna të gjithë grevistët - përkundër të drejtës së garantuar të grevës - dhe nuk donë t'ia dijë. Mirëpo problemet mbetën të pazgjidhura.

Të punësuarit në shitjen me pakicë kërkojnë një Kontratë Kolektive të Punës dhe së fundi edhe paga korrekte minimale. Ky është mjeti më i mirë kundër kushteve të këqija të punës. Bashkë me sindikatat në gjithë botën protestuan sindikatat përmes një dite aksioni ndërkom-bëtar kundër kushteve të këqija të punës.

Natalie Imboden
përgjegjëse e sektorit për shitje me pakicë

News

Ditë me dritë për punonjësit e Migros-it



Gjykata administrative e Cyrihut k publikuar më 10 tetor vendimin e vet, i cili kërkon që punonjësit e Migros-it në filialin nëntokësor të Rail-City në stacionin kryesor të hekurudhës në Cyrih, si paradite ashtu edhe pasdite gëzojnë të drejtën për 20 minuta pauzë me pagesë. Kush punon pa dritë të natyrshme dite ka të drejtë në pauzë me pagesë, për të thithur dritën e natyrshme të ditës. Shpërndarësit e mëdhenj të sektorit të tregtisë me pakicë bënë ankesë kundër këtij vendimi, pasi ky vendim bie me veti edhe kosto shtesë.

Kushtet e punës në ndërmarrjet transportuese

Një delegacion i sindikatës Unia dhe asaj Syndicom kanë protestuar para të dërguarit e BE-së në Zvicër, Richard Johns, kundër kushteve të mjerueshme në ndërmarrjet e transportit evropian. Bashkëkryetari i Unia-s Renzo Ambrosetti ia tërhoqi vërejtjen Ambasadorit të BE-së për gjendjen e mjerueshme në ndërmarrjet e transportit ndërkombëtar. Ai kërkoi nga ky i fundit të angazhohet kundër dumpingut në paga dhe kundër firmave (fiktive) të kutive postare. Shpesh punësohen shoferët e vendeve evropiane që praktikojnë paga tejet të ulëta dhe me kushte pune nga vendet e tyre të prejardhjes, edhe pse kryejnë punën transportuese në vendet me paga më të larta dhe me përfitime sociale më të mira. I dërguari i Be-së Jones u tregua i hapur për preokupimet e sindikatave transportuese dhe i ofroi Renzo Ambrosettit që në bisedimet e ardhshme të diskutohen propozime përmirësuese.

KB në Katar: karton i kuq për FIFA-n



Gjendje katastrofale në kantieret e stacioneve për Kampionatin Botëror të futbollit në Katar: Punëtorët e ndërtimit trajtohen si skllëvër dhe të drejtat e tyre të punës pësojnë lëndim masiv. Sipas një studimi të The Guardian-it britanik që nga qershori deri në gusht kanë humbur jetën 44 punonjës nepalesian. Më 3 tetor Unia dhe sindikata ndërkombëtare e ndërtimit dhe të drurit (BHI) përmes një aksioni para selisë kryesore të FIFA-s kanë kërkuar nga komiteti ekzekutiv të merr seriozisht përgjegjësinë sociale që i takon. Mediat nga e tërë bota kanë raportuar mbi këtë aksion.

Shitja me pakicë, pagat minimale

4000 franga pagë minimale tek Lidl

Me komunikatën për rritjen e pagës minimale për të punësuarit e pakualifikuar, shpërndarësi i madh Lidl në fillim të tetorit doli në titujt e lajmeve. Por me rastin e inspektimeve rezultoi se lajmi i mirë kishte edhe kurthet e saj.

Pagë minimale 4000 franga për punonjësit e pakualifikuar: kjo do të ishte lartësia e siguruar në Kontratën Kolektive të Punës për shitjen me pakicë në Zvicër. Kjo ngritje sipas Lidl duhet të vlejë nga dhjetori i këtij viti. Lidl që nga publikimi i lajmit bënë shumë propagandë për këtë rritje: «Lidl shpaguehet – edhe për punonjësit tanë». Risia, edhe pse në parim është për tu përshëndetur, ka shumë «mirëpo». Një «mirëpo» është, se kjo vlen vetëm për ata që janë të punësuar me orar të plotë (100%). Por në Lidl punojnë, sikur tek shumica e shitoreve me pakicë, të pakualifikuarit kryesisht me orar të kufizuar, shpesh vetëm me 60%. Një pagë që siguron ekzistencën pra nuk e marrin punëmarrësit tek Lidl.



Pamje nga shitoret e Lidl në Zvicër, ku mbretërojnë kushtet e këqija të punës

Përfitimet të këqija anësore të pagave

Shtrohet pyetja se mos është fjala për një trik propagandistik, për të bindur konsumatorët, se tek Lidl mbretërojnë kushte të mira pune. Përshtypja është e rreme, pasi ndër të tjera tek Lidl ka ndalesë konkurrence. Të punësuarit aty nuk kanë mundësi të punojnë tek një shitore tjetër me pakicë. Përpos kufizimit në punën anësore ka edhe

pasojat tjera, në krahasim me simotrat Coop dhe Migros, përfitime të këqija nga KKP-ja, pasi pagat janë të diferencuara sipas regjionit, apo se për shembull tek Coop-i 2/3 e kontributeve e të punësuarve në arkën e pensionit e merr përsipër punëmarrësi.

Iniciativa për pagat minimale ka filluar të ndikojë

Vendimi i Lidl për të ngritur pagat

minimale, tregon se paku se iniciativa për pagën minimale ka filluar të bëjë ndikimin e saj. Edhe tek Coop-i dhe Migros-i pagat minimale janë temë me rastin e bisedimeve të vjeshtës së sivjetme. Migros-i për shembull që nga viti 2009 nuk ka ngritur më pagën minimale prej 3700 frangave. Presioni pra është këtu, ai duhet të rritet edhe më tej!

Aurora Garcia

Shërbime, kamata e qirasë

Ulen kamatat referuese të qirasë: Kërkoni përshtatje të kostos së qirasë



Kërkoni bashkë me fqinjët qysh tani përshtatjen e kostos së qirasë!

Hipotekat janë duke u liruar gjithnjë e më shumë. Lirimi për qiranë e juaj bëhet i mundur vetëm nëse e kërkoni.

«Kërkoni uljen e qerasë!» Kështu ka vite që vijon të apelon shoqata e qiramarrësve. Me arsye: Kur të ndryshojnë kamatat referuese, kjo ndikon në lartësinë e kamatës së qirasë. Shumica e administratorëve dhe qiradhënësve e interpretojnë këtë në atë mënyrë, që me rastin e rritjes së kamatës referuese këtë menjëherë ua komunikojnë qiramarrësve. Mirëpo, kur zbritet kamata referuese, së pari nuk ndodh asgjë: Qiradhënësi pret se a do të jenë aktiv qiramarrësit. Mjerisht janë të paktë ata që vepro-

jnë: Shoqata e qiramarrësve vlerëson që më pak sesa 20% e qiramarrësve përfitojnë nga përshtatja e kamatës, në të cilën kanë të drejtë ligjore.

S'ka konsekuencë

Shumë qiramarrës nuk e dinë, që kanë të drejtë në reduktim të qirasë, të cilën duhet ta kërkojnë vet. Të tjerët kanë frikë nga konsekuencat, për shembull se atyre do tu ndërpritet kontrata e banimit. «Kjo nuk ndodhë» qetëson Peter Macher, drejtues i shoqatës zvicerane të qiramarrësve.

Qiradhënësit e dinë saktësisht, se një sjellje tillë është keqpërdorim i prishjes së kontratës.

Justifikime bajate

Ato që shoqata e qiramarrësve i dëgjon shpesh, janë arsytimet bajate të qiradhënësve. Për shembull se përfitimi është shumë i ulët. «Në 99% të rasteve kjo është një përpjekje për të hequr qafe qiramarrësit» thotë Macher. Kjo para së gjithash vjen në shprehje kur kamata e hipotekave është shumë e ulët. Një arsytim tjetër i paqëndrueshëm: Banesa edhe ashtu është shumë më e lirë se sa çmimet e vlefshme në lagje e në vendbanim.

Peter Macher: «Edhe me argumente të tilla në shumicën e rasteve nuk arrijnë asgjë administratorët dhe qiradhënësit. Ata duhet dëshmuar se së paku tri banesa të ngjashme në lagje janë më të lira». Kjo nuk është e thjeshtë për tu dëshmuar. Standardi i ndërtimit (dielli, zhurma, pozita dhe kyçja në mjetet e komunikacionit publik), vjetëria e objektit, stili ndërtues, bile edhe kati i banimit në të cilin gjendet banesa, duhet të jenë të përafërta. «Pos tjerash këto banesa krahasuese nuk guxojnë ti takojnë të njëjtit pronar», thotë Macher. Edhe në rast të rezervimeve (përfitimet e «ulëta», qiraja «e lirë» krahasuese) që qëndrojnë në kontratë, nuk vlejnë. Macher këshillon: «Mos lejoni t'ju heqin qafe. Kërkoni zbritjen e kamatës. Kush është këmbëngulës ka më së shumti sukses».

Tre hapa për zbritjen e kamatës së qirasë

Me këta tre hapa mund të zbritni kamatën e qirasë:

- Përlllogaritni se a keni të drejtë në zbritje. Të dhënat e nevojshme i gjeni në kontratën e juaj të banesës: <http://goo.gl/cAjHIG>
 - Shkarkoni mostrën e letrës, plotësojeni dhe nënshkruajeni atë: <http://goo.gl/xS6W2g>
 - Letrën dërgojeni rekomandë në adresë të qiradhënësit apo administratoratës gjegjëse.
- Zbritja e kamatës së qirasë ndodh disa muaj më vonë. Varësisht nga afatet e kontratës suaj dhe terminet kjo mund të zgjasë tre deri në gjashtë muaj. Qiradhënësi ka kohë deri në 30 ditë për tu përgjigjur. Nëse juve ju refuzohet zbritja pjesërisht apo krejtësisht, ju duhet të drejtoheni menjëherë tek shoqata e qiramarrësve për këshillim. Edhe njëherë deri në 30 ditë pas marrjes së përgjigjes duhet të ndërmerrni hapat tjerët të nevojshëm.

Sina Bühler përshtatur nga work, 15/2013

Tregoni më tej

Njoftoni fqinjët Tuaj. Nëse tërë ndërtesa kërkon përshtatjen e kamatës së qirasë, atëherë nuk jeni vet. Tek shoqata e qiramarrësve mund të porositni falas fletëpalosjen gjegjëse. Informata tjera: <http://goo.gl/wQBq3j>. Këshillimoret juridike të shoqatës së qiramarrësve, të cilat veprojnë në të gjitha kantonet ju mbështesin në raste të problemeve. Anëtarësia për një vit dhe për një familje apo bashkësi banimi kushton mes 70 deri 100 franga. www.mieterverband.ch; www.asloca.ch

Votimet federale

Votimet e nëntorit: Për paga dhe kushte pune korrekte



Dymbëdhjetë herë pagë më shumë në kuadër të një ndërmarrjeje është më se mjaftueshëm

Më 24 nëntor votuesit zviceran duhet tu drejtohen kutive votuese. Ndër të tjera këto votime do të vendosin për iniciativën 1:12 të socialistëve të rinj (shkurt: Juso), e cila iniciativë kërkon të kufizohen pagat e sipërme. Në zgjedhjet e kaluar na u dashtë të pranojmë disa disfata: Në Cyrih u refuzua qartas iniciativa për të drejtën e votimit për të migrantët. Ndërsa u votua për zgjatjen e orarit të punës për shitoret në pikat e shitjes së karburanteve. Liberalizimi i orarit të punës nëpër shitore, ashtu si tregojnë disa mocione, do të vijojë deri në pakufi.

Më 24 nëntor të gjitha personat me drejtë vote në Zvicër do të votojnë se a do të kufizohen pagat e sipërme në kuadër të një ndërmarrjeje. Krahas votimit për iniciativën 1:12, do të votohet edhe për dy propozime. Njëra për ngritjen e çmimit të përdorimit të autostradës nga 40 në 100 franga. Ndërsa tjetra për iniciativën familjare të SVP-së (Partisë Popullore të Zvicrës). Kjo e fundit parasheh që, prindërit që përkujdesen vet për fëmijët e tyre, të kenë mundësi zbritjeje nga tatim-pagimi të shumës së njëjtë sikur prindërit që delegojnë përkujdesen e fëmijëve të tyre tek të tjerët (çerdhet, grupet e lojës, etj.). Unioni i Sindikatave Zvicerane sugjeron refuzimin kësaj iniciative, e cila ka për synim të imponojë modelin e

familjes tradicionale. «Zbritja e tatimit për përkujdesje jashtë familjes» ka filluar të zbatohet ka tri vite, me çka u mundësohet çifteve që punojnë që të mos u shkon tërë fitimi në përkujdesje të fëmijëve të tyre. Këtë të arritur duhet ruajtur.

Po pagave të drejta e të ndershme

Iniciativa 1:12 e socialistëve të rinj është një nismë e rëndësishme. Ajo kërkon që batakinjve mashtrues tu vihet një kufi. Ideja e iniciativës është që asnjë punëmarrës për një vit të mos merr pagë më të ulët se sa ai që në të njëjtën ndërmarrje ka fitimin më të lartë, e i cili për një muaj merr rrogën e atij që punon një vit të tërë. Hendeku mes atyre që fitojnë pak dhe atyre që fitojnë shumë në 30 vitet e fundit është rritur në mënyrë dramatike: Raporti i pagës së një top menaxheri me pagën mesatare ishte 1:6, ndërsa sot është 1:43.

Para të mjaftueshme për të gjithë

Paratë që «kursehen» përmes këtij kufizimi do të mund të shpërndahej në formë të ngritjes së pagave. Për shembull, nëse paga e shefit të Lindt & Sprüngli do të shkurtohej në raportet 1:12, të gjithë të punësuarit (mbi 1200) e këtij prodhues të njohur çokolatash zvicerane do të kishin një rritje page prej së paku 400 frangash në muaj. Nuk qëndron as argumenti se me aprovimin e kësaj iniciative dëmtohet arka e sigurimit të pleqërisë, pasi që të gjithë do të kishin

më shumë para në kuletë. Kështu shembulli bie rritet e dhe konsumi. Kështu bie poshtë edhe një vërejtje tjetër, se gjoja iniciativa 1:12 dëmton ekonominë zvicerane. Andaj të gjithë ata që kanë të drejtë vote të votojnë për: PO!

➤ Aurora García

Liberalizimi i orarit të punës



Në votimin e zhvilluar herën e fundit u aprovua ndryshimi i ligjit të punës. Kështu për herë të parë hyri në fuqi puna 24 orësh në shitoret e pikave të shitjes së karburanteve. Pas komunikimit të rezultateve Unia ka tërhequr vërejtjen, që kjo të përfundoj me kaq. Mirëpo vetëm tri ditë pas kësaj parlamenti vijoi më tej me taktikën e hapave të njëpasnjëshëm (të njohur edhe si taktika e sallameve), duke aprovuar një mocion të parlamentarit Buttet. Ky mocion parasheh që shitoret e vogla në regjionet anësore të kenë të drejtën të punësojnë personel edhe të dielave. Mocioni Bettet plotëson mocionin e aprovuar të parlamentarit Abate. Ky dëshiron që shitja të dielave në «territoret turistike» të definohet me zemërgjerësi deh me mbulesë gjithëpërfshirëse. Ministri Schneider-Ammann donë që mocionin e Abate ta zbatojë pa pyetur për këtë popullin. Për Unia-n këto vendime të parlamentit janë përpjekje për të qar më tej punën të dielave në sektorin e shitjes me pakicë.



Flamuri 1.12 valon gjithandej



Vendose edhe ti në ballkon!

Intervistë



Andi Rieger, ish bashkëkryetari i Unia-s

Intervista: Iniciativa mbi të ardhurat e pakushtëzuara themelore

Të ardhura themelore për të gjithë?

Më 4 tetor është dorëzuar iniciativa popullore për të ardhurat e pakushtëzuara themelore, iniciativë kjo që shpesh ndërrohet gabimisht me iniciativën për pagën minimale. Andi Rieger, ish bashkëkryetari i Unia-s, në vijim na i shtjellon dallimin mes të ardhurave themelore dhe pagës minimale.

Cili është dallimi mes «të ardhurave të pakushtëzuara themelore» dhe pagës minimale?

Të ardhurat e pakushtëzuara themelore do ti merrte secili banor i Zvicrës, pa kushtin, që dikush ndonjëherë të ketë punuar. Autorët e iniciativës popullore mendojnë për një shumë prej 2500 frangave për person; mirëpo kjo në iniciativë nuk është përcaktuar. Paga minimale është minimumi. Që duhet të marr një punëtor apo një e punësuar. Iniciativa popullore e sindikatës, për të cilën duhet të votoj populli i Zvicrës, kërkon një pagesë minimale prej 22 frangash për një orë pune; kjo i përgjigjet një paga mujore rreth 4000 franga dymbëdhjetë herë në vit.

Cilat argumente flasin për fuqizimin e të ardhurave themelore?

Nëse të ardhurat themelore do të caktoheshin në lartësinë prej 2500 frangash në muaj, kjo do të paraqiste një lloj sigurie themelore për të gjithë. Njeriu do ta dinte se nuk do të vuante nga uria, apo se nuk do të duhej të kërkonte mbështetje sociale, nëse për shembull dikush për vite të tëra nuk ka pasur punë më.

A është i mundur fare financimi i të ardhurave themelore prej 2500 frangash në muaj?

Të ardhurat themelore kushtojnë me miliarda. Nëse aprovohet iniciativa popullore, atëherë parlamenti sipas të gjitha gjasave do të përcaktonte shumëllojshmëri rreth 1000 apo 1500 franga. Nëse kjo do të shërbejë për të zëvendësuar pensionin e pleqërisë AHV/AVS dhe atë të invaliditetit IV/AS, atëherë kjo paraqet reduktim masiv social.

A nuk do të rrezikoheshin me këtë rast pagat mbi këtë shumë?

Natyrisht se do të reduktoheshin pagat, pasi punëdhënësit do tu thoshin të punësuarve të tyre se ata marrin nga shteti të ardhura themelore. Në të njëjtën kohë do të rriteshin shkurtime dhe pagave apo vlera e shtuar tatimore, pasi të ardhurat themelore kushtojnë me miliarda dhe ato do të duhej të financoheshin.

A e mbështet Unia këtë iniciativë?

Ne nuk e kemi mbështetur iniciativën me rastin kur ajo është lansuar. Prioriteti ynë ishte dhe mbetet iniciativa për pagën minimale të garantuar me ligj. Para se iniciativa të dali në votim Unia dhe Unioni i Sindikatave të Zvicrës do të diskuton se për cilën parullë votuese do të vendos.

Çka do të ndodhte me sigurimet e tanishme shoqërore?

Rreziku është i madh që pas shkakimit të këtij revidimi total, në rastin e sigurimeve shoqërore do të mbeteshin për pak të ardhura në kuletën e të papunëve si dhe të pensionistëve të pleqërisë dhe atyre të invaliditetit. Cilat do të ishin pasojat e të ardhurave themelore për shoqërinë? Shumica e njerëzve parapëlqejnë që të kalojnë jetën me të ardhura të sigurt, të cilat i kanë fituar me punën e tyre. Edhe pensionet e pleqërisë e shohin si diçka që e kanë siguruar me vet. Me pensionin e pakushtëzuar themelor pavarësisht e njerëzve nuk rritet, përkundrazi ata bëhen më të varur. Andaj ne me më dëshirë angazhohemi për pagën e garantuar minimale prej 4000.- frangash për të gjithë. Si sindikatë ne pos tjerash luftojmë edhe më tej për punësim të plotë. Të gjithë duhet të gjejnë një punë. Këtu kemi të bëjmë me një rrezik të mëtejshëm që paraqesin të ardhurat e pakushtëzuara themelore: Politika me këtë rast mund të heq dorë nga punësimi i plotë dhe tu thotë të papunëve «Ja ku i keni të ardhurat e garantuara».

➤ Marília Mendes

Portret artistësh, krijuesish e veprimtarësh shqiptarë në Zvicër

«Ne duhet të tregojmë atë që dimë të bëjmë!»

Në Shqipëri Liri Lushi ishte një yll pasi interpretoi në skenë heroinën e vendit të saj. Tani ajo i ndihmon bashkëkombasit e saj të integrohen këtu. Të jetosh në mërgim do të thotë vec të tjerash edhe stres, konflikte dhe ndonjëherë edhe zhgënjim. Në një situatë të tillë në familjet shqiptare në Cyrih, është e pranishme Liri Lushaj me funksionin e saj.



Aktive edhe në grupin e sindikalistëve shqiptar «Aktivistët» të Cyrihut

Një ndërtesë zyrtare në rrugën «Schaffhauserstrasse» të Oerlikonit në Cyrih. Në katin e parë gjenden Zyrat e «Change Kultur», një organizatë kjo, e cila mbështet të rinjtë me sfond migracioni në rrugën e tyre për integrim profesional e social. Këtu Liri Lushaj punon si pedagoge sociale. Në vitin 2001 Liria erdhi nga Shqipëria në Zvicër. Para disa ditësh ajo aplikoi për marrje të shtetësisë zvicerane. Enti përkatës vërtetoi se përbushen parakushtet për shtetësi: 12 vite qëndrimi të pandërprerë në Zvicër, njohuri të mira gjuhësore, kualifikime të mëtejshme pasuniversitare, ushtrimi i një profesioni, si dhe të ardhura të majftueshme. Tani mbetet të plotësohen formularët përkatës. «Do të doja të kisha shtetësinë zvicerane», thotë Liri Lushaj, «pasi në këtë formë mund të jem plotësisht e integruar. Duke qenë zvicerane mund të marr pjesë në zgjedhjet e vendit dhe të kem të drejtën të votoj. Vetem kështu kam mundësi të përfaqësohem me mendimin dhe qëndrimin tim. Por kjo nuk është e vetmja arsye. Pasaporta zvicerane do të ishte gjithashtu njohje dhe pranim i një pune të kryer mirë.»

Profesioni: Ndermjetesuese e konflikteve

Liri Lushaj punon në lëmin e pedagogjisë sociale, kryesisht me familjet shqiptare, të cilat përballen me kriza. Kriza te cilat sjellin konflikte, prindër të mbingarkuar, fëmijë problematikë, për të mos thënë edhe delikuent. Detyra e saj është të definojë këtë krizë, të ndërmjetësojë, të informojë, të përkthejë gjithçka që është e pakuptueshme, të sqarojë ato që kuptohen gabimisht dhe kështu për këtë situatë të nderlikuar të ndihmojë për krijimin e një perspektivë të re.

Liri Lushi e di që shumica dërrmuese e bashkëkombësve të saj vijnë në Zvicër me vullnetin e mirë të respektojnë njerëzit dhe vendin nikoqir dhe me shpresën për tu integruar. Por veçanërisht pengesat gjuhësore çojnë në situata të pasigurta, ndonjëherë edhe deri tek lëndimet. Kështu rritet frika për tu shprehur, njerëzit mbyllën në vetvete, dhe nga këto situata lindin vështirësi të ndryshme.

Gjuha si parakusht integrimi

«Vështirësia kryesore me siguri që është gjuha» thotë ajo. Këtë e vëren ajo në radhe të parë tek gratë shqiptare. «Kur bisedohet me to shqip në kornizat private, atëherë ato janë plot vitalitet, të interesuara dhe kureshtarë. Mirëpo për ti motivuar ato p.sh. për të mësuar gjermanisht, apo edhe vetëm për të dalë nga shtëpia, ose për tu angazhuar në sindikatë, kjo është pothuajse e pamundur. Ato tërhiqen në vetvete, në vend se të tregojnë se çka dinë dhe çka munden.» Edhe pse Liri Lushi komunikon shqip, familjet shqiptare jo rrallë janë skeptike: «Unë e ndjej pyetjen e tyre të brendshme: Vjen kjo grua për të ndihmuar, apo është dërguar për të na kontrolluar ne?». Ndoshta duhet të jetë kjo arsyeja që gjatë bisedës sonë ajo nuk do të tregojë ndonjë shembull konkret, si e zgjidh ajo konkretisht një konflikt. Besimi i fituar tek njerëzit është për të shumë i rëndësishëm. Për këtë arsye ajo nuk dëshiron të bisedojë për raste dhe shembuj konkret. Sukses i arritur dëshmon për një pune të bere me se miri. «Për mua është kënaqësi nëse kam mundësi të ndihmojë drejtpërdrejtë.»

Skena teatrore mësim per jeten

Krahas punës së saj profesionale, Liri Lushi si artiste dhe pedagoge teatri, drejton qendrën integruese për socio-kulturë «Aleksandër Moissi» me seli në Cyrih të cilën e ka themeluar se bashku me kolegë të tjerë në vitin 2004. «Sa here që lexoja ndonjë artikull gazete të lidhur me ndonjë veprim dhune, kisha frikë se do të dilte aty emri i ndonjë shqiptari apo kosovari.» Për këtë arsye ajo ka vendosur të punojë me njerëz, të cilët kanë probleme. «Unë dua të përdor teatrin si medium për zgjidhjen e problemeve socio-kulturore», shpjegon ajo. Forma e përdorur në këtë lloj teatri është afërsisht e tillë: Ne studjojmë pjesën bashkë me fëmijët, dhe kur realizohet shfaqja vijnë edhe prindërit në skenë dhe bëhen pjesë e spektaklit. Kjo krijon situata shumë interesante: «Fëmijët të cilët druhen të shprehin mendimin e tyre në shtëpi tek prindërit, në skenë i shperthejnë lirshëm emocionet, pasi në ato momente – ata luajnë teatër.» Efekte të tilla të ngjashme ata përjetojnë edhe gjatë luajtjes se roleve të ndryshme, për shembull kur fëmija luan rolin e nënës. «Kjo formë inskenimi shkrin kufirin mes jetës reale dhe teatrit, pra mund të zhvillohet një proces i frytshëm.» Liri Lushi rikthehet edhe një herë tek tema e shtetësisë: «Ky është një hap drejt një integrimi me të plotë.» Për këtë arsye pedagogia sociale dhe artistia ka një mendim të qartë për çështjen, e cila po diskutohet këtu dhe nga parlamenti: A do të shkurtohet afati minimal i lejes së qëndrimit si kusht për marrjen e shtetësisë nga dymbëdhjetë në tetë vjet: «Për të gjithë ata që duan të integrohen, ky afat i shkurtuar do të ishte një motivacion i vërtetë, që ata të jenë më aktiv.»

Fredi Lerch | Fotot Florian Bachmann Përshtati në shqip: Meriona Telo

Artistja e teatrit dhe filmit

Liri Lushi (*1954) është rritur në kryeqytetin e Shqipërisë në Tiranë, ku edhe edhe studioi artin. Me emrin artistik Liri Lushi ka punuar më shumë se njëzet vite në qytetin bregdetar të Durrësit, po ashtu edhe si aktore e filmit shqiptar. Ajo u bë yll i artit në botën shqiptare pas luajtjes së rolit të suksesshëm të luftëtares së lirisë Shote Galica (1895 deri 1927) në pjesën e filmuar teatrale «Gërsheti i luftërave» (1978). Në vitin 2001 ajo erdhi në Zvicër, përvetësoi gjuhën gjermane dhe absolvoi kualifikime të ndryshme pasuniversitare. Aktualisht Liri Lushi po absolvon një master në Shkollën e Lartë (ZHAW) në Zürih për fushën e kriminalitetit, asocialitetit dhe masave parandaluese. Ajo punon si pedagoge sociale tek «Change Kultur» në Oerlikon të Cyrihut. Në kohën e lirë ajo drejton qendrën integruese «Aleksandër Moissi». Në Zvicër si artiste filmi ka luajtur në filmin me teme mbi kriminalitetin «Strahl» si dhe në serinë televizive «Tag und Nacht». Liri Lushi është anëtare e Unia-s, jeton në Winterthur dhe është nënë e dy fëmijëve të rritur.



Ju pyesni, Unia përgjigjet



E sëmure gjatë shtatzënisë: A lejohet të mi shkurtojë pushimet?

Më 16 gusht ka lindur fëmija ynë i parë: Që nga ajo kohë gjendem në pushim lehonie. Mjerisht gjatë shtatzënisë kisha probleme të mëdha shëndetësore. Për këtë arsye që nga fillimi i qershorit deri në lindje mjeku më ka dhënë vërtetimin e të sëmures. Tani shefja ime përmes një letre ma ka komunikuar se këtë vit mi ka shkurtuar pushimet vjetore. Si arsyetim qëndronte: «Paaftësisë për punë për shkak të komplikimeve me rastin e shtatzënisë si dhe pushimit katërbëdhjetë javësh të lehonisë.» A guxon ajo të bëjë diç të tillë?

Jo. Nëse një grua sëmuret për shkak të shtatzënisë, shkurtimi i pushimeve vjetore lejohet vetëm në rast se mungesa zgjat më shumë sesa tre muajt plotë. Shkurtimi për shkak të pushimit të lehonisë në çdo rast është i pa tolerueshëm. Pasi mungesa juaj për shkak të shtatzënisë ka zgjatuar vetëm dy muaj e gjysmë, shefja juaj nuk ka të drejtë t'ju shkurttojë juve pushimin vjetor. Se a është në rregull shkurtimi i pushimeve, jo gjithmonë mund të vendoset lehtë. Andaj në rast të dyshimit mos ngurroni të drejtoheni tek sekretariati juaj i Unia-s për të marrë këshillën juridike. Në përgjithësi vlen: Në të drejtën obliguese (neni 329 b) është e rregulluar se a guxon punëdhënësi pushimet apo jo. Nëse punëmarrësi nuk është fajtor, si në rastin e sëmures, aksidentit apo shërbimit ushtarak, atëherë në shkurtim i pushimeve është i mundur vetëm në rast se mungesa ka zgjatuar mbi dy muajt plotë e më gjatë. Tek dy muaj mungesë shkurtimi paraqet 1/12 e pushimit vjetor ligjor dhe për secilin muaj mungese tjetër të plotë pjesën e 1/12 tjetër. Muajt e ndërprerë nuk merren parasysh me rastin e shkurtimit të pushimeve vjetore.

Peter Schmid, work, 3.10.2013

Zyrat temporale: Ndalea e konkurrencës e palejuar?

Unë jam punësuar përmes një zyre ndërmjetësuese me afat të kufizuar për tre muaj si murator tek një kompani e shfrytëzuar. Kontrata e punës me firmën temporale parasheh që unë nuk kam të drejtë të punësohem drejtpërsëdrejti tek firma në fjalë. Unë mendoj se një ndalesë e tillë konkurrence është e palejuar. A është kështu?

Varet se si është e formuluar ndalesa e konkurrencës. Lexojeni saktësisht në kontratën tuaj të punës ndalesën konkrete të konkurrencës. Nëse ndalesa i referohet kohëzgjatjes tremujore të kontratës suaj të punës me firmën temporale, atëherë kjo është e lejuar. Në të kundërtën nuk është e lejuar nëse ndalesa duhet të vlejë edhe pas përfundimit të afatit të kontratës suaj me firmën temporale. Sipas ligjit për ndërmjetësimin e punës një marrëveshje nuk vlen, nëse ajo pas përfundimit të marrëdhënies së punës ia pamundëson apo vështirëson punëmarrësit punësimin në kompaninë shfrytëzuese.

Myriam Muff, work, 5.9.2013

AHV/AVS: A marr pensionin e pleqërisë automatikisht me 65 vjet?

Unë i bëj në nëntor 65 vjet dhe kështu edhe pensionohem: A qëndron se unë nga dhjetori 2013 marrë në mënyrë automatike pensionin tim të pleqërisë AHV/AVS?

Jo. Ju duhet të lajmëroni të drejtën e juaj tek Arka e kompensimit të AHV/AVS, për të marrë pensionin. Bënë këtë lajmërim më së miri menjëherë. Fondit të kompensimit i nevojiten së paku tre deri katër muaj kohë, për të siguruar pagesën me kohë. Pa lajmërimin me shkrim tek fondi i kompensimit nuk ka mundësi të përlogaritë përfitimin dhe të paguajë atë, pasi ajo nuk njihet e juaja bankare apo postare. Pos kësaj fondi në fjalë duhet t'ia komunikoni gjendjen e juaj civile, pasi kjo ka ndikim në pensionin tuaj. Ju duhet të lajmëroheni tek ai fond i kompensimit, i cili deri më tani ka pranuar kontributet tuaja të AHV/AVS. Punëdhënësi juaj mund t'ju thotë se për cilin fond është fjala. Formularin e lajmërimit për pensionin e pleqërisë mund ta merrni tek Arka kompetente e AHV/AVS si deh filialeve të saja, si dhe përmes: www.ahv-iv.info.

Heinrich Nydegger, work, 22.8.2013

Impressum: **Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen** work, area, Événement syndical | **Herausgeber** Verlagsgesellschaft work AG, Zürich, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | **Redaktionskommission** A. García, D. Filipovic, E. Sariasslan, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | **Spracherantwortlich** Osman Osmani | **Layout** C. Lonati, Unia | **Druck** Ringier Print, Adligenswil | **Adresse** Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.